



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI

C.nr.420/09

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti, në kontestin e paditësit I. Ç. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson e autorizuara e tij av.V. K. – G. nga Prishtina, kundër të paditurve K. e S. “I” me seli në Prishtinë dhe K. e S. “K. e R.” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 26.02.2013, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit I. Ç. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson e autorizuara e tij av. V. K.-G. nga Prishtina, andaj **detyrohen**:

- e paditura e parë K.S “I.” me seli në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve të shërimit, t’ia kompenzoj paditësit shumën prej 1066 euro, ndërsa në emër të shërimit klimaterik, shumën prej 247,20 euro;

- e paditura e dytë K.S. “K. e R.” me seli në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve të shërimit, t’ia kompenzoj paditësit shumën prej 1599 euro, ndërsa në emër të shpenzimeve të shërimit klimaterik, shumën prej 370,80 euro, të gjitha këto me kamatë vjetore sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, të llogaritura nga data 24.04.2008, e deri në pagesën definitive, brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

II. DETYROHET e paditura e parë K.S. “I.”, që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 1318,40 euro, ndërsa e paditura e dytë K.S. “K. e R.”, që në emër të shpenzimeve procedurale, t’ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 1977,60 euro, brenda afatit 15 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor i caktuar me datën 26.02.2013, është mbajtur në mungesë të të paditurës së dytë K.S. “K. e R.”, për të cilën gjykata ka pasur prova se e njëjta është ftuar në mënyrë të rregullt, e në bazë nenit 423.4 të LPK-së.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Shqyrtimi i sërishëm në këtë çështje kontestimore është mbajtur vetëm sa i përket pjesës së kërkespadiës së paditësit e cila ka të bëjë me shpenzimet e shërimit, shpenzimet e shërimit klimaterik dhe shpenzimet procedurale, ngase me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.388/2009, të datës 18.05.2012, është refuzuar si i pabazuar revizioni i të paditurës K.S. "I.", i paraqitur kundër pjesës aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.396/2008, të datës 25.05.2009, përveç në pjesën II të dispozitivit përkitazi me kamatën e aprovuar, në të cilën pjesë është pranuar revizioni dhe i njëjti aktgjykim është ndryshuar ashtu që është detyruar e paditura e (parë) K.S. "I.", që shumë e aprovuar në këtë pjesë të dispozitivit në lartësi prej 8.871,20 euro, paditësit t'ia paguajë me kamatë si për mjetet e deponura me kursim me afat mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 24.08.2008, e tutje deri në pagesën definitive, ndërsa që me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.396/2008, të datës 24.04.2008, është aprovuar pjesërisht ankesa e të autorizuarëve të palëve ndërgjyqëse, është prishë aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.651/06, i datës 24.04.2008, në pjesën e cila ka të bëjë me shpenzimet e shërimit, shërimit klimaterik dhe shpenzimet e procedurës, kështu që për këtë pjesë të kërkespadiës së paditësit, lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.02.2013, e autorizuara e paditësit av. V. K. G., ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë pjesës së kërkespadiës së paditësit që ka të bëjë me shpenzimet e mjekimit, shpenzimet e mjekimit klimaterik dhe shpenzimet e procedurës. Në fjalën e saj të fundit, ka kërkuar që bazuar në provat e administruara në këtë seancë, gjykata t'i aprovoj shpenzimet e lartpërmendura të mjekimit dhe ato të mjekimit klimaterik duke e llogaritur edhe kamatën në nivel vjetor sa paguajnë bankat afariste për deponimin e mjeteve të qytetarëve mbi një vit pa destinim të caktuar, të llogaritura nga data 24.04.2008, si datë e marrjes së aktgjykimit të kësaj gjykate C.nr.651/06, e deri në pagesën definitive. Njëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale të cilat gjykatës i'a ka dorëzuar të specifikuara me shkrim në këtë seancë.

I autorizuari i të paditurës së parë K.S. "I." H. I. nga Prishtina, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.02.2013, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë theksimeve të dhëna në seancat e kaluara duke e kundërshtuar në tërësi këtë pjesë të kërkespadiës së paditësit e cila ka të bëjë me shpenzimet e mjekimit dhe mjekimit klimaterik. Në fjalën e tij të fundit ka shtuar se kundërshtimi i tij bazohet në arsyen se përgjatë procedurës nga ana e paditësit, gjykatës i janë ofruar për administrim në cilësi të provave disa kupona, e jo edhe faturat e rregullta, e që për të paditurën e parë janë prova të papranueshme, ngase sipas tij këto prova mund të jenë si të besueshme po jo edhe si të vërtetuara në tërësi. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, nga gjykata ka kërkuar që të njëjta t'i aprovojë vetëm ato që janë të vërtetuara dhe të drejta. Përndryshe shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E autorizuara e të paditurës së dytë K.S. "K. e R.", N. B. nga Prishtina, në seancën e shqyrtimit përgatitor të datës 30.01.2013, nuk është deklaruar në lidhje me këtë pjesë të kërkespadiës së paditësit, me arsyetimin se për të njëjtën do të deklarohet në seancën e shqyrtimit kryesor. Siç edhe u cek më lartë, seanca e shqyrtimit kryesor e datës 26.02.2013, është mbajtur në mungesë të të paditurës së dytë K.S. "K. e R.", për të cilën gjykata ka pasur prova se e njëjta është ftuar në mënyrë të rregullt, e në bazë nenit 423.4 të LPK-së.

Në të vërtetë, duke u bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.388/2009, të datës 18.05.2012, del se në këtë çështje kontestimore nuk është kontestuese baza e kërkespadiës. Kontestuese paraqiten të jenë shpenzimet e mjekimit, shpenzimet e mjekimit klimaterik, e rrjedhimisht edhe ato të procedurës. Andaj, në këtë drejtim e për vërtetimin sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat si në vijim: dëftesa me numër 484, e datës 17.10.2006; kuponi i shërbimit të poliklinikës “Gjinolli”, me numër 00348, i datës 07.09.2006; kuponi me numër 2669, i ambulancës rentgenologjike “Ropris”, i datës 29.07.2006; kuponi me numër 047778, i datës 07.07.2006; kuponi me numër 047755, i datës 30.06.2006; fletëpagesa me numër 0807466, i datës 18.06.2006; dëftesëpagesa me numër 0173548, e datës 12.07.2006; fatura me numër 003303, e datës 14.08.2006, e lëshuar nga KRO “Rezonanca” në Prishtinë; fatura me numër 0434, e datës 12.08.2006, e lëshuar nga KR “Rezonanca” në Prizren; fatura me numër 003302, e datës 14.08.2006, e lëshuar nga KRO “Rezonanca” në Prishtinë; fatura me numër 003319, e datës 17.08.2006, e lëshuar nga KRO “Rezonanca” në Prishtinë; fatura me numër 682937, e datës 03.08.2006, e lëshuar nga NTShM “Akustika” në Prishtinë; kuponi me numër 031394, i datës 27.06.2006, i lëshuar nga NTP “Humana” në Prishtinë; kuponi me numër 0477770, i datës 05.07.2006, i lëshuar nga NTP “Humana” në Prishtinë; kopja e faturës me numër 003402, e datës 29.08.2006, e lëshuar nga KRO “Rezonanca” në Prishtinë; kopja e faturës me numër 003858, e datës 01.11.2006, e lëshuar nga KRO “Rezonanca” në Prishtinë; kopja e dëftesës me numër 530, e datës 23.11.2006, e lëshuar nga ambulanca për terapi fizikale “Rehabilitimi” në Prizren; si dhe fatura me numër 02-03295, e datës 19.09.2007, e lëshuar nga Instituti “dr. Simo Millosheviq” në Igallo të Republikës së Malit të Zi, bashkë me bonin fiskal.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkespadija e paditësit është e bazuar.

Nga leximi i dëftesës me nr. 484, të datës 17.10.2006, të lëshuar nga ambulanca për terapi fizikale “Rehabilitimi”, gjykata ka vërtetuar faktin se për shkak të tretmanit fizikal të kryer në këtë ambulancë, paditësi ka pasur shpenzime të shërimit klimaterik në lartësi prej 210 euro, më saktësisht sikurse në këtë dëftesë.

Nga leximi kuponit të shërbimit të poliklinikës “Gjinoli”, me numër 00348, të datës 07.09.2006, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi është trajtuar në këtë poliklinikë, respektivisht tek ai është kryer operimi i hematomit subdural, ku për shkak të këtij intervenimi i njejtë ka pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 1.300 euro, më saktësisht sikurse në këtë kupon.

Nga leximi i kuponit me numër 2669, të datës 29.07.2006, të lëshuar nga ambulanca rengenologjike “Ropris”, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 30 eurove, më saktësisht sikurse në këtë kupon.

Nga leximi i kuponit me nr.047778, të datës 07.07.2006, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 170 euro, më saktësisht sikurse në këtë kupon.

Nga leximi i kuponit me nr.047755, të datës 30.06.2006, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 170 euro, më saktësisht sikurse në këtë kupon.

Nga leximi i fletëpagesës me nr.0807466, të datës 18.06.2006, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 40 euro, më saktësisht sikurse në këtë fletëpagesë.

Nga leximi i dëftespagesës me nr.0173548, të datës 12.07.2006, gjykata ka konstatuar faktin se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 30 eurove, më saktësisht sikurse në këtë dëftespagesë.

Nga leximi i faturës me nr.003303, të datës 14.08.2006, të lëshuar nga KRO “Rezonanca” në Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 90 euro, më saktësisht sikurse në këtë faturë.

Nga leximi i faturës me nr.0434, të datës 12.08.2006, të lëshuar nga KR “Rezonanca” në Prizren, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 90 euro, më saktësisht sikurse në këtë faturë.

Nga leximi i faturës me nr.003302, të datës 14.08.2006, të lëshuar nga KRO “Rezonanca” Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka patur shpenzime të shërimit në lartësi prej 190 euro, më saktësisht sikurse në këtë faturë.

Nga leximi i faturës me nr.003319, të datës 17.08.2006, të lëshuar nga KRO “Rezonanca” në Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka patur shpenzime të shërimit në lartësi prej 60 euro, më saktësisht sikurse në këtë faturë.

Nga leximi i faturës me nr.682937, të datës 03.08.2006, të lëshuar nga NTSHM “Akustika” në Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka patur shpenzime të shërimit në lartësi prej 20 euro, më saktësisht sikurse në këtë faturë.

Nga leximi i kuponit me nr.031394, të datës 27.06.2006, të lëshuar nga NTP “Humana”, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi pa pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 170 euro, më saktësisht sikurse në këtë kupon.

Nga leximi i kuponit me nr.047770, të datës 05.07.2006, të lëshuar nga NTP “Humana”, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 170 euro, më saktësisht sikurse në këtë kupon.

Nga leximi i kopjës së faturës me nr.003402, të datës 29.08.2006, të lëshuar nga KRO “Rezonanca” në Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit në lartësi prej 110 euro, më saktësisht sikurse në këtë faturë.

Nga leximi i kopjës së faturës me nr.003858, të datës 01.11.2006, të lëshuar nga KRO “Rezonanca” në Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka patur shpenzime të shërimit në lartësi prej 20 euro, më saktësisht sikurse në këtë faturë.

Nga leximi i kopjës së dëftesës me nr.530, të datës 23.11.2006, të lëshuar nga ambulanca për terapi fizikale “Rehabilitimi” në Prizren, gjykata ka vërtetuar faktin se

paditësi ka patur shpenzime të shërimit klimaterik në lartësi prej 240 euro, më saktësisht sikurse në këtë dëftesë.

Nga leximi i faturës me nr. 02-03295, të datës 19.09.2007, të lëshuar nga Instituti “dr. Simo Milosheviq” – Igalo - Republika e Malit të Zi, bashkë me bonin fiskal, gjykata ka vërtetuar faktin se për shkak të trajtimit në këtë institut, paditësi ka pasur shpenzime të shërimit klimaterik në lartësi prej 168 euro, më saktësisht sikurse në këtë faturë.

Baza ligjore

Me nenin 195 al.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ndër të tjera parashihet se **“kush i shkaton tjetrit lezionim trupor ose ia prish shëndetin ka për detyrë t’i kompensoj shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë...”**.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Në bazë të provave të administruara në këtë riprocedurë, gjykata e ka aprovuar pjesën e kërkespadiës së paditësit që ka të bëjë me shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e mjekimit klimaterik, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë riprocedurë, është konstatuar se për shkak të aksidentit të trafikut të datës 15.06.2006, ndër të tjera, paditësi ka pësuar edhe lëndime trupore, për shkak të të cilave lëndime të njëjtit edhe i është dhënë trajtimi përkatës mjekësor. Në bazë të shkresave të lëndës, për shkak të natyrës së lëndimeve të marra në aksidentin në fjalë, del se shërimi i paditësit është zhvilluar në formë të shërimit klinik, për të vazhduar pastaj në formë të shërimit klimaterik - rehabilitues. Me rastin e shërimit të tij, përkatësisht të shërimit klimaterik të tij, paditësi ka pasur shpenzime të caktuara, për të cilat gjykatës i’a ka parashtruar dëshmitë - provat përkatëse, të cilat janë administruar në këtë procedurë. Sipas vlerësimit të gjykatës, provat e administruara në këtë riprocedurë, janë të besueshme, andaj si të tilla gjykata atyre edhe ua fali besimin e plotë, për çka edhe pjesa e kërkespadiës së paditësit e cila ka të bëjë me shpenzimet e shërimit si dhe shpenzimet e shërimit klimaterik, u aprovua si e bazuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrur konform nenit 452 të LPK-së dhe tarifës zyrtare për përfaqësime dhe atë si në vijim: për përfaqësim në 16 seanca gjyqësore nga 101 euro për seancë, shumën prej 1616 euro; për përpilimin e padisë, shumën prej 78 euro; për precizim të kërkespadiës, shumën prej 78 euro; për ekspertizën e ekspertit aktuar, shumën prej 250 euro; për ekspertizën e ekspertit të komunikacionit shumën prej 180 euro; për ekspertizën e vlerësimit të dëmit të veturës, shumën prej 120 euro; për ekspertizat mjeko ligjore shumën prej 300 euro; për taksën e klauzolës së plotfuqishmërisë (së pjesërishme) aktgjykimit C.nr.651/06, të datës 24.04.2008, shumën prej 210; për shpenzimet e përfaqësimit në rigjykim, në seancën e datës 13.12.2009, shumën prej 101 euro; për përfaqësim në rigjykim në seancën e datës 13.12.2012, shumën prej 121 euro; për përfaqësim në rigjykim në seancën e datës 30.01.2013,

shumën prej 121 euro dhe për përfaqësim në rigjykim në seancën e datës 26.02.2013
shumën prej 121 euro.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.420/09, datë 26.02.2013

Procesmbajtësja,
Drita Qerreti

Gjyqtari,
Valon Totaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditësh, pas marrjës së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.